



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 5.11.2021

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV NR.31, DATË 27.10.2021 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020 “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”, TË NDRYSHUAR”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 5 nëntor 2021 shqyrtoi aktin normativ nr.31, datë 27.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar. Akti normativ u shqyrtua sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatores, për këtë akt normativ, znj. Blerina Gjylameti.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtore e Përgjithshme e Buxhetit;
- Z. Endrit Lami, Drejtor i Drejtorisë së Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale;
- Znj. Brikena Jazxhi, Drejtore e Drejtorisë së Borxhit Publik.

II. Baza ligjore.

Akti normativ nr.31, datë 27.10.2021 është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet nga Kuvendi mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i tij kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.

- *Nevoja dhe urgjenca për miratimin e aktit normativ.*

Nevoja dhe urgjenca për miratimin e aktit normativ lindi për arsyet si më poshtë:

Së pari, rritja e menjëhershme e çmimeve në tregun e parregulluar të energjisë elektrike përkeqësoi situatën financiare të OSHEE, sha-së. Kjo shoqëri nuk zotëron mjetet financiare të nevojshme për blerjen e energjisë elektrike dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë të konsumatorëve. Për këtë arsye, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.584, datë 8.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” miratoi kërkesën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për financimin e mbështetjes financiare të OSHEE, sha-së në vlerën 200 milionë euro.

Nga ky fond, nevojat për vitin 2021 (sipas kërkesës së OSHEE, sha-së) janë në vlerën 100 milionë euro. Diferenca e fondit prej 100 milionë eurosh do të përdoret për vitin 2022.

Së dyti, në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, vlera e eurobondit që do të emetohet në tregjet ndërkombëtare është parashikuar 500 milionë euro.

Në kohën e hartimit dhe miratimit të ligjit nr.103/2021 “Për eurobondin që do të emetohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë”, vlera e eurobondit që do të emetohet në tregjet ndërkombëtare u parashikua në kufijtë 500-700 milionë euro.

Para hartimit të aktit normativ nr.31, datë 27.10.2021, u bë vlerësimi real i nevojës për financim, që do të mbulohet nga emetimi i eurobondit në tregjet ndërkombëtare për vitet 2021 dhe 2022, ku u përlllogarit që vlera e eurobondit duhet të jetë 700 milionë euro.

Rishikimi i vlerës së financimit me anë të eurobondit bëri të nevojshëm ndryshimin e ligjit për buxhetin e vitit 2021. Për këtë arsye, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ, i cili parashikon akomodimin e daljes me eurobond në tregjet ndërkombëtare, duke rritur vlerën e tij nga 500

milionë euro, në 700 milionë euro, përmes rritjes për këtë qëllim të kufirit të huamarrjes neto vjetore. Njëkohësisht, për të reflektuar situatën reale, referuar këtyre treguesve, në ligjin për buxhetin e vitit 2021 u rishikuan edhe zërat e tjerë të financimit, siç janë mbështetja buxhetore e pritshme për financimin e projekteve dhe ripagesat e borxhit.

- *Përmbajtja e aktit normativ.*

Akti normativ parashikon dy ndryshime në ligjin për buxhetin e vitit 2021, si më poshtë:

- ✓ *Së pari*, akordimin e mbështetjes financiare për OSHEE, sha-në, në formën e instrumentit të garancisë sovrane, në vlerën 10 miliardë lekë për vitin 2021;
- ✓ *Së dyti*, rritjen e kufirit të huamarrjes neto vjetore, për të akomoduar daljen me eurobond në tregjet ndërkombëtare, me një vlerë më të lartë se ajo e parashikuar fillimisht, pra nga 500 milionë euro, në 700 milionë euro.

- *Miratimi i ndryshimeve buxhetore me akt normativ.*

Ndryshimet e përcaktuara në aktin normativ plotësojnë kriteret e nevojës dhe urgjencës, të parashikuara në nenin 101 të kushtetutës, për arsye se:

- ✓ Mbështetja financiare me garanci sovrane e OSHEE, sha-së, është e nevojshme dhe duhet të bëhet brenda një kohe sa më të shpejtë, për të siguruar furnizimin e pandërprerë të konsumatorëve me energji elektrike;
- ✓ Rritja e kufirit të huamarrjes nëpërmjet eurobondit do të krijojë mundësinë për mbështetjen e nevojave buxhetore për vitet 2021 dhe 2022. Pra, në vitin 2022 nuk do të jetë më e nevojshme të emetohet eurobond. Emetimi i eurobondit duhet të bëhet brenda një kohe sa më të shpejtë, për të shfrytëzuar kushtet aktuale favorizuese të tregjeve të kapitalit.

Gjithashtu, akti normativ plotëson edhe kriterin e përkohshmërisë, të parashikuar në nenin 101 të kushtetutës, pasi ai vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë deri në 45 ditë. Pas kësaj periudhe, akti normativ duhet të miratohet me ligj nga Kuvendi.

IV. Efektet financiare.

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2021 sjellin rritjen e nivelit të borxhit publik me 38.9 miliardë lekë. Ndërkohë, treguesit e tjerë të buxhetit 2021, siç janë të ardhurat, shpenzimet dhe deficitin buxhetor nuk ndryshojnë.

V. Diskutimi në Komision.

Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, paraqiti aktin normativ dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Znj. Blerina Gjylameti, relatore e aktit normativ, theksoi se akti normativ është i domosdoshëm, për arsye se:

- ✓ *Së pari*, krijon mundësinë për mbështetjen financiare të Shoqërisë OSHEE, sha, për të përballuar rritjen e menjëhershme të çmimeve të energjisë elektrike dhe për të furnizuar në mënyrë të pandërprerë konsumatorët;
- ✓ *Së dyti*, pasqyron në ligjin e buxhetit 2021 nevojat reale për financim nëpërmjet eurobondit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Aktualisht, këto tregje kanë likuiditet të lartë dhe norma interesi të ulëta, si rrjedhojë e politikave lehtësuese të Bankës Qendrore Europiane apo të Rezervës Federale. Për të shfrytëzuar këto kushte favorizuese, dalja me eurobond nga vendi ynë duhet të bëhet në një kohë sa më të shpejtë.

Akti normativ u mbështet nga shumica e anëtarëve të Komisionit.

VI. Përfundim.

Mbështetur në argumentet si më lart, Komisioni e miratoi aktin normativ nr.31, datë 27.10.2021, të Këshillit të Ministrave, me shumicë votash.

RELATORJA

Blerina GJYLAMETI

KRYETARI

Eduard SHALSI